



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 772/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.12.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” shpk, “Neal 86” shpk dhe “Glavenica” shpk në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-34288-08-26-2019 me objekt “*Rikonstuksion Shkolla Jordan Misja*” me fond limit 28 331 597 lek pa tvsh, zhvilluar më datë 27.09.2019 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Nika” shpk nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues: “Kevin Konstruksion“ shpk
Rruga “Adem Jashari“, Nd.4, H.10 Tiranë

“Nika“ shpk
Rruga “|Bulevardi Skenderbeg“ pas kinema Millenium
Shkodër

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkodër
Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër

Subjekt i Interesuar: BOE Rroku Guest shpk& Shpresa-Al shpk
Rruga Nazmi Kryeziu, ndertesa 1/1, hyrja 2, Ap. 8,
Shkoder

Glavenica shpk
Lagja "5 Shkurti", Bulevardi "4 Heronjtë", godina nr.2,
apartament nr.3, kati.4, Ballsh

Neal -86 shpk
Sarande lagja 4

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit,

në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

I.4. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 26.08.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-34288-08-26-2019 me objekt “Rikonstuksion Shkolla Jordan Misja” me fond limit 28 331 597 lek pa tvsh, zhvilluar më datë 27.09.2019 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Në datën 27.09.2019 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 25.10.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

Delia Impex	pa ofertë	I skualifikuar
Nika	19,276,839	I skualifikuar
Rroku Guest	19,425,659.56	I kualifikuar
B-93	20,389,450	I skualifikuar
Neal-86	20,764,320	I kualifikuar
Colombo	21,054,254	I skualifikuar
Glavenica	21,772,290	I kualifikuar
Kevin Konstruksion	21,905,792	I kualifikuar
Sireta 2F	22,144,070	I kualifikuar
Karl Gega Konstruksion	23,114,980	I kualifikuar
Lacaj	23,158,032	I kualifikuar
Zdravo	25,598,120	I kualifikuar
SAG	25,704,970	I kualifikuar
Kaceddja	26,052,298	I kualifikuar
Rafin Company	26,620,140	I kualifikuar

II.4. Në datën 31.10.2019 operatori ekonomik “Kevin Konstruktion“ shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Kundërshtojmë vlerësimin e ofertave të paraqitura nga ana jonë si vijon:*
- *Neni 66 i VKM nr.914 datë 29.12.2014 me ndryshime sanksionon: Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta në përputhje me nenin 56 të LPP oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Shuma totale e arritur nga operatorët e kualifikuar është 255,900,671 lekë pa tvsh. Numri i operatorëve të kualifikuar është 11. Mesatarja e 11 operatorëve është 23.263,697 lekë pa tvsh. 85% e mesatares është 19,774,060 lekë pa tvsh. Oferta e OE Rroku Guest në shumën 19,425,659 lekë pa tvsh është anomalisht e ulët.*
- *Në pikën 2.2.4 të DT AK ka kërkuar: Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që verteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2019 (Sipas QKB) sipas percaktimeve në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore për vitin 2019.*
 1. *Në dijeninë tonë sipas ekstraktit të QKB për adresat kryesore dhe dytësore operatori ekonomik Neal 86 shpk nuk ka paraqitur në SPE vërtetimin për pagesën e taksave bashkiake në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet. Adresat sipas qkb Vlorë; Sarandë kamion vinc tip man me targë SR 5021B, Tiranë Njësia Administrative nr.7, Blv Gjergj Fishta, ndërtesa 32 kulla 1, kati 12, hyrja 1, Ap 60.*
 2. *Në dijeninë tonë sipas ekstraktit të QKB për adresat kryesore dhe dytësore operatori ekonomik Glavenica nuk ka paraqitur në SPE vërtetimin për pagesat e taksave bashkiake në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet. Adresat sipas QKB Fier, Ballsh, Tiranë, Shkodër.*
- *Në pikën 2.3.11 për kapacitetin teknik të DT është kërkuar: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes të pasqyruar në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, të paisur me kontrate pune (të vlefshme), me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jenë të paktën:*

<i>Muratorë</i>	<i>2 (dy)</i>	<i>punonjës</i>
<i>Teknik ndertimi</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>punonjes</i>
<i>Manovrator</i>	<i>2 (nje)</i>	<i>punonjes</i>
<i>Mekanik</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>punonjes</i>
<i>Hidraulik</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>punonjes</i>

Elektricist 2 (nje) punonjes

Manovratorët duhet të jenë punonjës të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda (eskavatorist) dhe për këtë duhet të paraqesin deshmë nga Drejtoria e Sherbimit të Transportit Rrugor ndërsa për teknikun e ndërtimit duhet të paraqitet diploma e shkolles/deshmë nga organe/institute të akredituar.

Në dijeninë tonë operatorët Rroku Guest shpk, Neal 86 shpk, Glavenica shpk nuk kanë plotësuar kriterin e lartpërmendur për shkak se në bazë të VKM nr.514 datë 20.09.2017 kodet e profesioneve të personave të paraqitur si specialist të certifikuar në listpagesat e operatorëve duhet të figurojnë si më poshtë:

<i>Murator -</i>	<i>Kodi 7112</i>
<i>Teknik Ndërtimi -</i>	<i>Kodi 3112</i>
<i>Manovrator -</i>	<i>Kodi 8342</i>
<i>Mekanik -</i>	<i>Kodi 3115</i>
<i>Hidraulik -</i>	<i>Kodi 7126</i>
<i>Elektricist -</i>	<i>Kodi 7411</i>

- *Në pikën 2.3.12 për kapacitetin teknik të DT është kërkuar: Operatori Ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme, si më poshtë:*
- *ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit cilësisë”, (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*
- *ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit ambjentit” (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*
- *BS OHSAS 18001:2007 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*

Në dijeninë tonë operatorët Rroku Guest, Neal 86, Glavenica nuk plotësojnë kriterin e kërkuar për shkak se certifikimi ISO i operatorëve Rroku Guest, Neal 86 Glavenica është kryer nga operatorë të paakredituar në RSH. Akreditimi i subjekteve që kryejnë certifikimin bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit. Verifikimi i listës së subjekteve të akredituar kryhet në adresën elektronike info@dpa.gov.al. DPA është autoritet publik që vepron si shërbimi kombëtar i akreditimit në RSH në varësi të MF sipas ligjit nr.116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në RSH.

Kualifikimi i operatorëve me certifikata të lëshuara nga subjekte të paakredituara në RSH është një veprim shumë i rëndë i KVO dhe i autoritetit kontraktor që sjell si pasojë përgjegjësi administrative dhe në disa raste edhe penale.

Neni 258 i Kodit Penal sanksionon: Kryerja nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik i veprimeve në kundërshtim me ligjet që rregullojnë lirinë e pjesmarrjes dhe barazinë e shtetasve në tendera dhe ankande publike për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Sa më sipër kërkojmë pranimin ndryshimin e vlerësimit të kryer nga KVO dhe pranim plotësisht të ankesës.

II.5. Në datën 06.11.2019 operatori ekonomik ankimues “Kevin Konstruksion” shpk ka marrë dijeni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor me shkresën nr.18613/1 datë 01.11.2019.

II.6. Në datën 08.11.2019 pala ankimuese “Kevin Konstruksion” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 25.10.2019 operatori ekonomik “Nika” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

- *Shtojca per kontratat ne process nuk eshte plotesuar sakte pasi mungon kontrata me Bashkine Korce”Per projekte per permiresimin e kushteve te banimit per komunitete te pafavorizuara,Bashkia Korce (Rehabilitim/Perforcim banesash ekzistuese)”. “Sherbim mirembajtje per Njesine Adminstrative Lekas”*
- *Certifikatave ISO te cilat jane te perkthyer dhe te noterizuara u ka mbaruar afati i vlefshmerise ndersa ato te cilat jane brenda afatit te vlefshmerise nuk jane te perkthyer dhe noterizuara.*
- *Specialisti për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë rezulton se është me profesion shofer dhe nuk ploteson kriteret në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 ”Për miratimin e rregullores ”Për sigurinë në kantier”*
- *Afati i vlefshmerise per policen e sigurimit per automjetin me targa SH 6271 E ka mbaruar me date 25.09.2019*
- *Ju nuk keni paraqitur dy kamioncina me kapacitet mbajtes deri me 3.5 ton*
- *Nuk keni paraqitur elektrosaldatrice*

II.8. Në datën 28.10.2019 operatori ekonomik “Nika” shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Vendimi është absolutisht i padrejtë dhe i bazuar në pretendime hipotetike dhe jo në fakte që ekzistojnë. Nga ana jonë janë plotësuar në mënyrë të përpiktë të gjitha dokumentat tekniko ligjore.*
- *Së pari në lidhje me pretendimin se kamionit me targa SH 6271 E i ka mbaruar afati i vlefshmërisë së siguracionit sqarojmë se nga ana jonë janë paraqitur makineri të llojit kamion disa herë më shumë se sa ajo që është kërkuar nga ana juaj. Konkretisht nga ana juaj është kërkuar 1 kamion me kapacitet mbi 10 ton ndërkohë që ky kriter është plotësuar nga ana jonë me disa kamiona që janë ngarkuar në SPE në dosjen përkatëse të procedurës së prokurimit. Kështu nga ana jonë për të plotësuar këtë kriter janë paraqitur kamionat nga Oliver Mulla, kamion nga Aldo Demaj, kamiona nga Alba Beton 07, kamion nga Tonin Koceku etj.*
- *Së dyti në lidhje me pretendimin se nuk është paraqitur elektrosaldatrice sqarojmë se një makineri e tillë është dorëzuar nga ana jonë konkretisht është e marrë me qera nga shoqëria Pako shpk. Për të provuar këtë fakt kemi ngarkuar në SPE kontratën e qerasë me shoqërinë Pako dhe faturën e blerjes përkatëse.*
- *Së treti në lidhje me pretendimin se certifikatat ISO janë të papërkthyer sqarojmë se ky fakt nuk qëndron pasi në sistem janë ngarkuar certifikata ISO fillestare dhe ato të azhornuara. Certifikatat ISO fillestare rezulton se janë të përkthyer dhe të noterizuara ndërkohë që ato të azhornuara janë identike në formë dhe në përmbajtje. E vetmja gjë që ndryshon është data e cila është e njëjtë në cdo gjuhë sic është ajo shqipe dhe ajo angleze në të cilën është lëshuar. Kjo duket qartë se është thjesht tendencë për skualifikim dhe jo argument bindës për të justifikuar vendimarrjen.*
- *Së katërti në lidhje me pretendimin se specialisti për sigurinë dhe shëndetin në punë rezulton të jetë i punësuar si shofer sqarojmë se ky fakt është i vërtetë por nuk përbën shkak për skualifikim. Pasi jo vetëm që është kërkuar nga ana juaj që specialisti për sigurinë dhe shëndetin në punë të ketë një profesion të caktuar por nga ana tjetër edhe ligjërisht nuk ka një profesion të caktuar. Është në varësi të politikave dhe metodologjive që zgjedh një kompani se cilin person lë përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë. Dhe është pikërisht ky person Gjergj Nika i cili është përzgjedhur nga ana jonë për të kontrolluar sigurinë dhe shëndetin në punë. Për këtë shkak është trajnuar dhe ka marrë dëshminë përkatëse për ta ushtruar këtë funksion.*
- *Së pesti në lidhje me pretendimin se nuk janë paraqitur dy kamioncina me kapacitet deri në 3.5 ton sqarojmë se nga ana juaj nuk janë kërkuar kamioncina me kapacitet deri në 3.5 ton por janë kërkuar 2 mjete transporti me kapacitet deri në 3.5 ton. Ky element kualifikimi është plotësuar nga ana jonë nëpërmjet paraqitjes së dy mjeteve respektive . Konkretisht janë ngarkuar në SPE për të plotësuar këtë kriter mjetet e transportit me targa AA 734 AV i emërtuar kamioncinë nga Luigj Shehu dhe kamioni tjetër nga Benet Ndoci me targa AA 328 HZ. Të dy këto mjete janë të shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm tekniko ligjor.*
- *Së gjashti në lidhje me pretendimin se nga ana jonë nuk janë deklaruar dy prej kontratave që kemi në proces dhe konkretisht ato më Bashkinë Korçë sqarojmë se ky është një devijim i vogël në kuptim të ligjit të prokurimeve. Edhe për rastin konkret është një devijim i vogël i cili nuk përbën shkak për skualifikim por thjesht është një*

tendencë për skualifikim. Kështu në bazë të përmbajtjes së deklartës së punëve në proces duhet të verifikohet fakti nëse kemi kapacitete teknike në përputhje me licencën profesionale që disponojmë. Kontrata shërbime mirëmbajtje njësia administrative Lekas sqarojmë se përmban punime që nuk futen fare në kategorinë e licencës së punimeve të kërkuara nga ana juaj. Po ashtu kontrata tjetër për mirësim i kushteve të komuniteteve të pafavorizuara nuk i kalon kapacitetet e licencës profesionale që disponojmë. Kjo kontratë është me vlerë afro 8 milion lekë ndërkohë që licenca jonë është në kategorinë E e cila ka kapacitet mbi 1 miliard lekë. Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e shoqërisë sonë.

II.9. Në datën 01.11.2019 me shkresën nr.18329/1 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Nika” shpk ku ka vendosur mospranim e ankesës.

II.10. Në datën 11.11.2019 pala ankimuese “Nika” shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.11. Nëpërmjet shkresës nr.20010 prot datë 19.11.2019 protokolluar me tonën me nr.1732/2 prot datë 22.11.2019 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nika” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Ju nuk keni paraqitur dy kamioncina me kapacitet mbajtes deri me 3.5 ton”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3/13 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. *Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :*

Nr	Mjetet	Sasia
----	--------	-------

1	Mjet transporti vetshkarkues mbi 10 (kapac.mbajtes)	1 cope
2	Mjet transporti vetshkarkues deri ne 3.5ton (kapac.mbajtes)	2 cope
3	Fadrome me goma	1 cope
4	Pompe suvatimi	1 cope
5	Elektropomp	1 cope
6	Autobetoniere	1 cope
7	Skeleri	500 m2
8	Depozite uji	1 cope
9	Vinc kulle/karrel	1 cope
10	Gjenerator	1 cope
11	Elektrosaldatriçe	1 cope
12	Rrjete suvatimi	500m2

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- i. Shtojcen nr. 10 te plotesuar.*
- ii. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).*
- iii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.*
- iv. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë **ku** të specifikohet afati i kontratës,*
- v. Per mjetet qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*
- vi. Te gjitha mjetet e deklaruar ne kete procedure tenderimi, (sipas shtojces 10) te shoqerohen me fotot përkatëse ku te jete i identifikuar mjeti ne fjale (targa etj).*

2. *Operatori ekonomik ofertues (Administratori i shoqërisë ofertuese), duhet të paraqesë një deklaratë që makineritë e kerkuara në piken 2.3.14, nuk duhet të jenë të angazhuara në ndonjë kontratë/kontrata të tjera në fuqi, dhe nuk janë të deklaruar në procedurat e shpallura fitues nga Autoritetin Kontraktor Bashkia Shkoder, por vetëm për këtë objekt. Gjithashtu në deklarate duhet të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi. Komisioni i vlerësimit të ofertës i lëndë drejta për të verifikuar në kantier disponueshmërinë e makinerive të deklaruar.*

III.1.2. Lidhur me këtë arsye skualifikimi ankimuesi në parashtrimet e tij në ankesë pretendon se kriteri lidhur me dy mjete transporti vetshkarkues deri në 3.5 ton është përmbushur nga ana e tij nëpërmjet paraqitjes së dy mjeteve respektive përkatësisht mjeti me targa AA 734 AV i emërtuar kamioncinë nga Luigj Shehu dhe kamioni tjetër nga Benet Ndoci me targa AA 328 HZ. Të dy këto mjete janë të shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm tekniko ligjor.

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik ankimues “Nika” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Qeraje Nr.7031 Rep Nr.2725 Kol datë 25.10.2017 lidhur ndërmjet Luigj Shehu në cilësinë e qeradhënësit dhe Nika shpk në cilësinë e qeramarrësit, me objekt, Kamioncinë me targa AA734 shasie ËF0BXXGBVBXM72779, shoqëruar me Certifikatë Pronësie të Mjetit Rrugor, Leje Qarkullimi, Foto, Certifikatë e Kontrollit Teknik, Policë Sigurimi, Taksa Vjetore e Mjeteve.
- Kontratë Qeraje datë 02.02.2017 lidhur ndërmjet Benet Ndoci në cilësinë e qeradhënësit dhe Nika shpk në cilësinë e qeramarrësit, me objekt Kamion me targa AA328 HZ me nr.shasie 38514714832274, shoqëruar me Leje Qarkullimi, Certifikatë e Pronësisë së Mjetit Rrugor, Foto, Policë Sigurimi, Certifikatë e Kontrollit Teknik (kamion nga 3.5 deri në 7.5 ton), Taksa vjetore e mjeteve, Certifikatë nr.84 datë 02.05.2019 Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.1.5. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 26 “Kontratat për Punë Publike” pika 8 përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”*

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomikë nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.6. KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.1.7. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e vecantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar kapacitetin teknik *“Mjet transporti vetshkarkues deri në 3.5 ton (kapac.mbjates)”* dy copë. Gjithashtu në kriter kërkohet shprehimisht se për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Ndërsa për të gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës. Për mjetet që shënohen në regjistra publik, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Nika” shpk konstatohet se në përmbushje të këtij kapaciteti ankimesi sikundër dhe pretendon në parashtrimet e tij në ankesë ka paraqitur dokumentacion tekniko ligjor për dy mjete përkatësisht Kamioncinë me targa AA734 dhe Kamion me targa AA328 HZ. KPP pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga ankimesi lidhur me këto dy mjete konstaton se vetëm mjeti me targa AA734 përmbush kriterin e kualifikimit për një mjet vetshkarkues me kapacitet mbsjtës deri në 3.5 ton. Konkretisht nga përlllogaritjet e kryera ky mjet ka kapacitet mbajtës 1.4 ton në përputhje me përcaktimet në kriterin e vecantë të kualifikimit. Ndërsa sa i takon mjetit me targa AA328 HZ KPP referuar dokumentacionit shoqëruar për

ky mjet konstaton se ky mjet është kamion dhe pas përlllogaritjeve të kryera rezulton se ka kapacitet mbajtës 8.3 ton cka nuk është në përputhje me kriterin e kualifikimit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të dorëzojnë ofertën në përputhje me dokumentet e tenderit dhe kërkesat e autoritetit kontraktor. KPP gjykon se operatori ekonomik ankimes nuk ka provuar se disponon në pronësi, apo me qira dy mjete vetshkarkuese me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton për plotësimin e kriterit të veçantë të kualifikimit.

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik "Nika" shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik "Nika" shpk mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe operatori ekonomik ankimes nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "Kevin Konstruktion" shpk për skualifikimin e operatorëve ekonomikë "Në pikën 2.3.11 për kapacitetin teknik të DT është kërkuar: *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes të pasqyruar në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, të paisur me kontrate pune (te vlefshme), me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jenë të paktën:*

<i>Muratorë</i>	<i>2 (dy)</i>	<i>punonjës</i>
<i>Teknik ndertimi</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>punonjes</i>
<i>Manovrator</i>	<i>2 (nje)</i>	<i>punonjes</i>
<i>Mekanik</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>punonjes</i>
<i>Hidraulik</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>punonjes</i>

Elektracist 2 (nje) punonjes

Manovratorët duhet të jenë punonjës të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda (eskavatorist) dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit të Transportit Rrugor ndërsa për teknikun e ndertimit duhet të paraqitet diploma e shkolles/deshmi nga organe/institute të akredituar.

Në dijeninë tonë operatorët Rroku Guest shpk, Neal 86 shpk, Glavenica shpk nuk kanë plotësuar kriterin e lartpërmendur për shkak se në bazë të VKM nr.514 datë 20.09.2017 kodet e profesioneve të personave të paraqitur si specialist të certifikuar në listpagesat e operatorëve duhet të figurojnë si më poshtë:

<i>Murator -</i>	<i>Kodi 7112</i>
<i>Teknik Ndërtimi -</i>	<i>Kodi 3112</i>
<i>Manovrator -</i>	<i>Kodi 8342</i>
<i>Mekanik -</i>	<i>Kodi 3115</i>
<i>Hidraulik -</i>	<i>Kodi 7126</i>
<i>Elektracist -</i>	<i>Kodi 7411</i>

III.3.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3/11 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- 1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të pasqyruar në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, të paisur me kontrate pune (te vlefshme), me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jenë të paktën:*

<i>Muratorë</i>	<i>2 (dy) punonjës</i>
<i>Teknik ndertimi</i>	<i>1 (nje) punonjes</i>
<i>Manovrator</i>	<i>2 (nje) punonjes</i>
<i>Mekanik</i>	<i>1 (nje) punonjes</i>
<i>Hidraulik</i>	<i>1 (nje) punonjes</i>
<i>Elektracist</i>	<i>2 (nje) punonjes</i>

Manovratorët duhet të jenë punonjës të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda (eskavatorist) dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit të Transportit Rrugor ndërsa për teknikun e ndertimit duhet të paraqitet diploma e shkolles/deshmi nga organe/institute të akredituar.

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatorët ekonomikë “Rroku Guest” shpk, “Neal 86” shpk, “Glavenica” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Rroku Guest&Shpresa AI

- Listpagesat e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore e Rroku Guest shpk

- Listpagesat e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore e Shpresa AI shpk
- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2017 lidhur ndërmjet Shpresa AI shpk dhe L.P në pozicionin Murator
- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2017 lidhur ndërmjet Shpresa AI shpk dhe F.G në pozicionin Murator
- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2017 lidhur ndërmjet Shpresa AI shpk dhe A. O në pozicionin Automakinist dhe Eskavatorist
- Kontratë Individuale Pune dt 04.01.2019 lidhur ndërmjet Shpresa AI shpk dhe P. D në pozicionin Drejtues Eskavatori
- Kontratë Individuale Pune dt 20.09.2016 lidhur ndërmjet Shpresa AI shpk dhe P.V në pozicionin Automakinist
- Kontratë Individuale Pune dt 07.01.2017 lidhur ndërmjet Shpresa AI shpk dhe S. O në pozicionin Mekanik
- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2017 lidhur ndërmjet Shpresa AI shpk dhe D.O në pozicionin Hidraulik
- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2017 lidhur ndërmjet Shpresa AI shpk dhe F.Gj në pozicionin Elektracist
- Kontratë Individuale Pune dt 07.11.2016 lidhur ndërmjet Shpresa AI shpk dhe A. Z në pozicionin Mekanik Automjetesh
- Kontratë Individuale Pune Nr. 3/6 prot datë 01.03.2019 lidhur ndërmjet Rroku Guest dhe I.R në profesionin Elektracist
- Kontratë Individuale Pune Nr. 3/3 prot datë 01.03.2019 lidhur ndërmjet Rroku Guest dhe Gj.V në profesionin Manovrator
- Kontratë Individuale Pune Nr.3/4 prot datë 01.03.2019 lidhur ndërmjet Rroku Guest dhe T.D në profesionin Murator
- Kontratë Individuale Pune Nr.3/2 prot datë 01.03.2019 lidhur ndërmjet Rroku Guest dhe V.G në profesionin Manovrator
- Kontratë Individuale Pune Nr.3/7 prot datë 01.03.2019 lidhur ndërmjet Rroku Guest dhe S.C në profesionin Hidraulik
- Kontratë Individuale Pune Nr.3/5 prot datë 01.03.2019 lidhur ndërmjet Rroku Guest dhe Rr.G në profesionin Teknik Ndërtimi.
- Kontratë Individuale Pune Nr.3/1 prot datë 01.03.2019 lidhur ndërmjet Rroku Guest dhe E.M në profesionin Manovrator.

Glavenica shpk

- Listpagesat e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore
- Kontratë Pune dt 07.01.2019 lidhur ndërmjet Glavenica shpk dhe T.M në detyrën Elektracist
- Kontratë Pune dt 07.01.2019 lidhur ndërmjet Glavenica shpk dhe A.Sh në detyrën Elektracist
- Kontratë Pune dt 07.01.2019 lidhur ndërmjet Glavenica shpk dhe E.K në detyrën Hidraulik

- Kontratë Pune dt 07.01.2019 lidhur ndërmjet Glavenica shpk dhe A.Q në detyrën Eskavatorist
- Kontratë Pune dt 07.01.2019 lidhur ndërmjet Glavenica shpk dhe K.Z në detyrën Manovrator
- Kontratë Pune dt 07.01.2019 lidhur ndërmjet Glavenica shpk dhe A.O në detyrën Manovrator
- Kontratë Pune dt 07.01.2019 lidhur ndërmjet Glavenica shpk dhe L.B në detyrën Teknik Ndërtimi
- Kontratë Pune dt 07.01.2019 lidhur ndërmjet Glavenica shpk dhe M.B në detyrën Murator
- Kontratë Pune dt 07.01.2019 lidhur ndërmjet Glavenica shpk dhe P.M në detyrën Murator
- Kontratë Pune dt 07.01.2019 lidhur ndërmjet Glavenica shpk dhe Sh.A në detyrën Murator
- Kontratë Pune dt 07.01.2019 lidhur ndërmjet Glavenica shpk dhe A.R në detyrën Mekanik

Neal 86

- Listpagesat e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore
- Kontratë Individuale Pune dt 09.01.2017 lidhur ndërmjet Neal 86 shpk dhe Q.T në profesionin Teknik Ndërtimi
- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2019 lidhur ndërmjet Neal 86 shpk dhe A.Xh në profesionin Saldator
- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2019 lidhur ndërmjet Neal 86 shpk dhe K.V në profesionin Manovrator
- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2019 lidhur ndërmjet Neal 86 shpk dhe S. Xh në profesionin Karpentier
- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2019 lidhur ndërmjet Neal 86 shpk dhe D.L në profesionin Karpentier
- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2019 lidhur ndërmjet Neal 86 shpk dhe G.V në profesionin Manovrator
- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2019 lidhur ndërmjet Neal 86 shpk dhe A.B në profesionin Hidraulik
- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2019 lidhur ndërmjet Neal 86 shpk dhe M. K në profesionin Hekurthyes
- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2019 lidhur ndërmjet Neal 86 shpk dhe N.P në profesionin Shofer
- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2019 lidhur ndërmjet Neal 86 shpk dhe M.P në profesionin Shofer
- Kontratë Individuale Pune dt 30.06.2017 lidhur ndërmjet Neal 86 shpk dhe V.G në profesionin Elektricitist
- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2019 lidhur ndërmjet Neal 86 shpk dhe M.L në profesionin Saldator

- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2019 lidhur ndërmjet Neal 86 shpk dhe A.I në profesionin Elektracist
- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2019 lidhur ndërmjet Neal 86 shpk dhe Sh.S në profesionin Murator
- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2019 lidhur ndërmjet Neal 86 shpk dhe R.I në profesionin Murator
- Kontratë Individuale Pune dt 03.01.2019 lidhur ndërmjet Neal 86 shpk dhe B.M në profesionin Mekanik

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.3.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 26 “Kontratat për Punë Publike” pika 8 përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”*

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.3.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, parashikohet:

1. Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Klasifikimi i Listës Kombëtare të Profesioneve, e njohur shkurtimisht si “LKP”, zbatohet për mbledhjen, klasifikimin dhe publikimin e të dhënave statistikore zyrtare.

3. Lista Kombëtare e Profesioneve (LKP) zbatohet nga agjencitë statistikore, ministritë e linjës, institucionet qendrore dhe vendore, personat fizikë dhe juridikë, brenda territorit të Republikës së

Shqipërisë.

4. Kodet statistikore të Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të përdorura deri para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, zëvendësohen me kodet e parashikuara në Listën Kombëtare të Profesioneve (LKP), bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Instituti i Statistikave dhe agjencitë e tjera statistikore kryejnë përditësimin e informacionit statistikor zyrtar, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Ngarkohen institucionet dhe subjektet e përmendura në pikën 3, për marrjen e masave përgatitore për zbatimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

III.3.6. Referuar kriterit të vecantë të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se operatorët ekonomik duhet të kenë të punësuar në stafin e tyre të pasqyruar në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, të paisur me kontrate pune (te vlefshme), me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, minimalisht Muratorë 2 (dy) punonjës; Teknik ndertimi 1 (nje) punonjes; Manovrator 2 (nje) punonjes; Mekanik 1 (nje) punonjes; Hidraulik 1 (nje) punonjes; Elektracist 2 (nje) punonjes.

III.3.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë BOE "Rroku Guest" shpk & "Shpresa" shpk, "Glavenica" shpk, "Neal 86" shpk në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të këtij kriteri rezulton se janë paraqitur kontratat e punës, dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për punonjësit e sipërcituar. Gjithashtu janë dorëzuar listpagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për periudhën e kërkuar nga ku KPP konstaton se për disa nga punonjësit e kontraktuar nga të tre operatorët ekonomikë pjesmarrës rezultojnë mospërputhje me kodet e profesioneve të përcaktuara në VKM nr. 514, datë 20.09.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve", në të cilën janë përcaktuar kodet përkatëse me profesionet sipas listës kombëtare. KPP vëren se punonjësit e deklaruar në kontratë për një pozicion të caktuar, faktikisht sipas listëpagesave të operatorëve ekonomikë "Rroku Guest" shpk & "Shpresa" shpk, "Glavenica" shpk, "Neal 86" shpk nuk janë të punësuar në atë profesion, fakt ky që nuk krijon sigurinë se operatori ekonomik përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Konkretisht nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga të tre operatorët ekonomikë rezultoi se BOE "Rroku Guest" & "Shpresa" shpk ka mospërputhje të theksuara të profesioneve të punonjësve të deklaruar në kontratë me kodet e deklaruara në listpagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të tilla si Murator të deklaruar si shofer kamioni, hidraulik si përgjegjës sektori apo punëtor krahu në ndërtim rrugësh, elektracist të deklaruar si xhenerik apo si mbështetës në ndërtim apo akoma më tej teknik ndërtimi të deklaruar si arkëtar qarkullimi monetar.

Gjithashtu edhe operatori ekonomik "Glavenica" shpk ka mospërputhje të theksuara të profesioneve të punonjësve të deklaruar në kontratë me kodet e deklaruara në listpagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të tilla si elektracist të deklaruar si punëtor krahu apo shofer, mekanik të deklaruar si punëtor krahu, hidraulik të deklaruar si shofer apo akoma më tej teknik ndërtimi të deklaruar si punëtor krahu.

Mospërputhje rezultuan edhe në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik "Neal 86" shpk për punonjësin e kontraktuar në detyrën e mekanikut i deklaruar në listpagesë me kodin 7124.01 që sipas VKM nr.514 datë 20.09.2017 të sipërcituar, i përket profesionit të punëtorit të izolimit.

III.3.8. Bazuar në kodet e profesioneve të deklaruara në listëpagesat, konstatohet se operatorët ekonomikë "Rroku Guest" shpk & "Shpresa" shpk, "Glavenica" shpk, "Neal 86" shpk nuk kanë paraqitur dokumentacion të vlefshëm për dia nga punonjësit si më sipër analizuar pasi pavarësisht se ata kanë paraqitur kontratat e punës së bashku me dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik lëshuar nga organet kompetente dokumentacioni ka mangësi, pasi në listpagesat e shoqërisë këta punonjës nuk janë deklaruar sipas përcaktimeve në VKM nr.514 datë 20.09.2017 por me kode të tjera të cilat krijojnë konfuzion sa i takon profesioneve të tyre.

III.3.9. Nisur nga sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon dhe vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatorët ekonomikë "Rroku Guest" shpk & "Shpresa" shpk, "Glavenica" shpk, "Neal 86" shpk në këtë procedurë prokurimi nuk arrijnë të provojnë faktin që këta operatorë ekonomikë për gjithë periudhën e kërkuar në dokumentat e tenderit kanë të punësuar në stafin e tyre punonjës me profesionet e kërkuara në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi të deklaruar me profesionet përkatëse në listpagesat e shoqërive ndaj dhe dokumentacioni i paraqitur prej tyre nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

III.3.10. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.11. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatorët ekonomikë do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se *"Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti*

kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me intepretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatorët ekonomikë do të kishin paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Kevin Constuksion” shpk qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruksion” sh.p.k. mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” shpk & “Shpresa” shpk, “Glavenica” shpk, “Neal 86” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi referuar gjykimin mësipër gjendja faktike dhe juridike e operatorëve ekonomikë do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesat e ankimuesit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-34288-08-26-2019 me objekt “Rikonstruksion Shkolla Jordan Misja” me fond limit 28 331 597 lek pa tvsh, zhvilluar më datë 27.09.2019 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nika” shpk për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” shpk & “Shpresa” shpk, “Glavenica” shpk, “Neal 86” shpk,” shpk duke i skualifikuar ata.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1732 Protokolli; Datë 08.11.2019

Nr. 1739 Protokolli; Datë 11.11.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha